



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 40.2 shkronja c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, Qarkores Buxhetore 2023/01 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, përcjellur përmes Shkresës nr.prot.01/400 996/2022 të datës 13.05.2022, neneve 14 dhe 34 paragrafi 2.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori:

VENDIM PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2023-2025 TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Podujevës për periudhën 2023/2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023/2025 e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-400/01-0053045/22
Podujevë, datë: 30.06.2022



Presuesi i Kuvendit
Milmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E FINANCAVE

**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE**

2023-2025

Podujevë

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2023-2025

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Podujevës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike për të përmbushur objektivat e përcaktuara zhvillimore të Komunës së Podujevës.

Si pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2023-2025, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2023 dhe parashikimet, që janë miratuar nga Komisioni i Granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH), e miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Podujevës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2023 – 2025, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë dhe
- Ligjin e buxhetit.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025, planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2023-2025, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

Objektivat e Komunes se Podujevës:

- Përmirësimi i infrastrukturës në qytet
 - Përmirësimi i infrastrukturës në fshatra
 - Krijimi i një qyteti të zhvilluar me plan urbanistik
 - Ngritja e nivelit të arsimit, duke krijuar kushte të mira për zhvillimin e arsimit dhe duke e lidhur me ekonominë
 - Zhvillimi i shëndetësisë duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët
 - Rritja e mirëqenies sociale
 - Zhvillimi i kulturës, rinisë dhe sportit
 - Përkrahja e bizneseve në mënyrë që të ulët papunësinë
 - Zhvillimi i turizimit
 - Zhvillimi i bujqësisë
- Këto objektiva të Komunës së Podujevës janë objektiva që përputhen edhe me objektivat e qeverisë së Kosovës të cilat janë të shprehura në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në programin e qeverisë.

Objektivat dhe përfitimet e procesit të Kornizes Afatmeseme Buxhetore per vitet 2023-2025

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit në kode ekonomike;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Rritja e të hyrave vetanake:

- Rritja e efikasitetit në arkëtim;
- Rritja e bazes së tatimpagueseve.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;
- Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve.

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe me udhëzimet administrative;

- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
 - Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
 - Krijimi i kushteve për prodhuesit vendorë
 - Mbeshtetje buxhetore për fermerët
- Korniza Afatemeseme Buxhetore 2023-2025 është e përpiluar në përputhje me Qarkoren Buxhetore për komuna 2023 dhe ligjit mbi Menaxhmin e Financave dhe kjo kornizë duhet të përmbajë strategjinë fiskale të Komunës për periudhen e ardhshme tre vjeçare.

Tabela 1: Buxheti i Komunës sipas Qarkores Buxhetore 2023/01

Organizatrat buxhetore	Aktuali	Plani	Projeksione	
	2022	2023	2024	2025
Granti i Pergjithshëm	9,160,666	12,119,450	13,000,657	13,862,676
Granti i Arsimit	9,728,422	9,859,607	10,573,638	10,616,588
Sherbimet Rezidenciale		160,000	175,000	175,000
Granti nga Shëndetësia priu	3,073,967	3,330,767	3,497,305	3,672,171
Teatri "Avdush Hasani"	130,249	130,249		
Te hyrat vetanake	1,356,216	1,806,493	1,883,659	1,966,658
TOTALI	23,449,520	27,406,566	29,130,259	30,293,093

Parashikimi i të hyrave vetanake

- Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës realizohen në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal, rregulloreve komunale si dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat i përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, të cilat komuna ka të drejtë ti arkëtojë.
- Bazen e të hyrave vetanake komunale në Komunën e Podujevës e përbën tatimi ne pronë.


Të hyrat e Komunës për periudhën 2023-2025, parashihen të arkëtohen nga:

- Tatimi ne pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa administrative komunale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa për certifikata
- Qira nga objektet
- Qiraja për tokën
- Partecipimi në shëndetësi
- Partecipimi në arsim

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	2021 (aktuali)	2022 (aktuali)	2023 (plani)	2024 (vlerësimet)	2025 (vlerësimet)
TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	22,802,359	23,449,520	27,406,566	29,130,259	30,293,093
TË HYRAT VETANAKE	1,416,561	1,356,216	1,806,493	1,883,659	1,966,658
Tatimi në Pronë	410,105	468,437	438,616	447,388	458,573
Tatimi ne tokë	166,790	210,000	319,872	335,866	352,659
Taksat Komunale	505,666	390,779	681,005	731,005	788,426
Licencat dhe lejet	100,000	90,000	150,000	155,000	170,000
Certifikatat zyrtare	130,000	100,000	150,000	155,000	170,000
<i>Taksat për automjete</i>	80,000	60,000	80,000	90,000	100,000
Lejet e ndërtimit	150,000	105,779	216,005	236,005	248,426

Taksat e tjera Komunale	45,666	35,000	85,000	95,000	100,000
Agjensioni i pyjeve					
Ngarkesat Komunale	254,000	227,000	227,000	227,000	227,000
Ngarkesat rregullative					
Qiraja	80,000	80,000	80,000	80,000	80,000
Bashkë-pagesat arsim	98,000	75,000	75,000	75,000	75,000
Bashkë-pagesat shënd.	76,000	72,000	72,000	72,000	72,000
Ngarkesat tjera komunale					
Të hyrat tjera	40,000	30,000	80,000	82,400	80,000
Gjobat e Gjykates	40,000	30,000	60,000	60,000	60,000
TRANSFERET QEVERITARE	21,385,798	22,093,304	25,600,073	27,246,600	28,326,435
Granti i Përgjithshëm	8,765,246	9,290,915	12,409,699	13,175,657	14,037,676
Granti për Arsim	9,546,585	9,728,422	9,859,607	10,573,638	10,616,588
Granti për Shëndetësi	3,073,967	3,073,967	3,330,767	3,497,305	3,672,171



Korniza komunale e shpenzimeve buxhetore

Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik fiskal dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2022.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vjet si dhe rritje të granteve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-it.

Buxheti i Komunes per vitet 2023 - 2025

Buxheti i Komunës për vitin 2023

Qarkorja -2023/01

Nr	Emertimi i Drejto	kodet	kodi-	stafi	Paga	Mallra	Komuna	Subvencio	Kapitale	Totali-2023	Totali-2024	Totali-2025
1	Zyra e Kryetarit	160/16005	111	19	150,343	-				150,343	150,343	150,343
2	Zyra e Kuvendit	169/16905	111		142,349					142,349	142,349	142,349
3	Administrata	163/16305	133	70	410,062	289,126	288,000		80,000	1,067,188	1,002,382	1,006,562
4	Buxhet dhe Financa	175/17505	112	22	141,903	-				141,903	141,903	141,903
5	Planifikim dhe Zhv	480/48005	411	9	63,179	15,000			450,000	528,179	528,179	578,179
6	Inspektimet	166/16609	411	17	113,109	35,000				148,109	148,109	148,109
7	Bujqësia	470/47005	421	21	110,879	-			-	110,879	110,879	110,879
8	Kadastrri dhe Gjeod	650/65025	610	19	112,070	5,000				117,070	117,070	118,070
9	Planifikim Urban	660/66030	620	15	84,852	92,000			3,500,507	3,677,359	4,316,948	5,256,737
10	Infrastruktur Publi	180/18165	451	12	77,440	660,000	-	-	2,330,000	3,067,440	3,887,440	3,612,440
11	Zjarrfiksit	180/18225	320	18	116,932	-	-			116,932	116,932	116,932
12	Kultura Rini e Sport	850/85005	820	17	109,560	70,000			310,000	489,560	449,560	499,560
13	Teatri Avdush Hasani			12	80,199	-		50,050		130,249	130,249	130,249
13	ZKK	195/19725	1090	2	13,473	-				13,473	13,473	13,473
	Administrata (A)	920/92025	980	12	83,526	-				83,526	83,526	83,526
	Administrata (SH)	730/73014	760	10	68,689	-			160,000	228,689	243,689	243,689
	Shërbimet Sociale	755/75521	1040	13	81,229	-	-			81,229	81,229	81,229
	Totali I Gran. Pergjithshem			288	1,959,794	1,166,126	288,000	50,050	6,830,507	10,294,477	11,664,260	12,434,229
14	Arsim dhe Shkenc	920/911	912/9	1465	9,045,762	1,049,067	130,000	90,000	1,660,000	11,974,829	12,085,035	12,220,035
15	Shëndetsia (QKMF)	730/73300	721	264	1,868,080	822,706	50,000		589,981	3,330,767	3,497,305	3,672,171
	totali			2017	12,873,636	3,037,899	468,000	140,050	9,080,488	25,600,073	27,246,600	28,326,435

TE HYRAT VETANAKE

Programet	Stafi	Paga	Mallra	Komunali	Subvencione	Kapitale	Totali-2023	Totali-2024	Totali-2025
Zyra e Kuvendit							-		
Administrata							-		
Infrastruktur Publike					100,000	-	100,000	100,000	100,000
Planifikim Urban						199,493	199,493	256,659	219,658
Planifikim dhe zhvillim					300,000	-	300,000	300,000	300,000
Bujqesia					700,000	-	700,000	700,000	800,000
Kultur, Rini e Sport					200,000	-	200,000	200,000	200,000
Arsim dhe Shkenc		47,000	28,000		10,000		85,000	95,000	105,000
Shëndetsia (QKMF)		49,000	23,000				72,000	72,000	72,000
Administrata (SH)						150,000	150,000	160,000	170,000
Totali I THV		96,000	51,000		1,460,000	199,493	1,806,493	1,883,659	1,966,658
	2017	12,969,636	3,088,899	468,000	1,600,050	9,279,981	27,406,566	29,130,259	30,293,093

Tabela : Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Zyra e kryetarit :

Kryetar: Z. Shpejtım Bulliqi

Deklarata e Misionit: Realizon administrimin e përgjithshëm të Komunës, bën zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës. Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj.

Përgjegjësitë e Kryetarit

Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- e) emëron apo shkarkon nënkryetarin e tij/saj;
- f) emëron dhe shkarkon drejtorët të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës; dhe
- k) mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtoj një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve; dhe
- l) Aktivitetet tjera që i caktohen me Statut.

Buxheti i planifikuar në Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve,

Buxheti për zyrën e Kryetarit:

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	150,343	150,343	150,343
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	150,343	150,343	150,343
	Stafi	19	19	19

Zyra e Kuvendit Komunal

Deklarata e misionit:- Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e rregulloreve, vendimeve,etj) në funksion të qeverisjes sa më të mirë dhe efikente të të gjitha drejtorive të Shërbimit civil të Komunës, gjithnjë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës.

-Kordinimi i punëve me të gjitha drejtoritë e Shërbimit civil të Komunës, këshilltarëve të kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative dhe Komiteteve jo obligative, komiteteve konsultative dhe KKSBB me subjektet relevante të Nivelit Qendror dhe atij lokal, OJQ-të, bizneset, etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e komunës së Podujevës

Buxheti për Zyren e Kuvendit Komunal

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	142,349	142,349	142,349
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	142,349	142,349	142,349
	Stafi			

Drejtoria për Administratë:

Bënë zbatimin e dispozitave ligjore, akteve nënligjore si dhe akteve të përgjithshme;

-përgatitjen e materialit të Kryetarit të komunës, të Kuvendit, Komiteteve dhe të Komisioneve tjera;

-krijimin e kushteve të barabarta për qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj;

-avancimin dhe organizimin e punës në organet komunale të Administratës;

-lëshimin e certifikatave dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me gjendjen statusore;

-kryerja e punëve të përbashkëta për organet e Administratës si menagjimi dhe mirëmbajtja në përgjithësi e aparaturës kompjuterike në zyrat e Administratës, pranimin e parashtrësive, dorëzimin dhe ekspeditimin e parashtrësive ,

vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimeve, arkivimin e lëndëve, sigurimin e objekteve, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre si dhe shfrytëzimin e automjeteve;

Buxheti per Drejtorinë e Administrates:

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	410,062	410,062	410,062
2	Mallra dhe shërbime	289,126	302,500	305,500
3	Shpenzime komunale	288,000	290,000	291,000
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	80,000		
	Gjithsej:	1,067,188	1,002,562	1,006,562
	Stafi	70	70	70

Drejtoria për Buxhet e Financa:

- Veprimtaria e Drejtorisë për Buxhet e Financa, është mbështetur në kompetencat e përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe implementimin e rregulloreve të aprovuara në Kuvendin e Komunës si dhe në bazë të instruksioneve financiare të aprovuara nga MEF-i dhe plan programeve të punës së drejtorisë.
- Drejtoria për Buxhet e Financa është përgjegjëse për:
 - Përgatitjen e buxhetit .
 - Përgatitjen e bazës ligjore për realizimin e buxhetit të planifikuar.
 - Menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit.
 - Përgatitjen e dinamikës së shpenzimit të buxhetit.
 - Rishikimin e buxhetit.
 - Menaxhimin e fondeve dhe monitorimin e sistemit në procesin e ekzekutimit të buxhetit.
 - Transferi i mjeteve vetanake dhe donatorëve në B.K.K.
 - Alokimin e mjeteve dhe zotimin e tyre sipas prioriteteve të caktuara.
 - Barazimin e të hyrave vetanake dhe shpenzimeve me Departamentin e Thesarit.
 - Menaxhimin e shpenzimeve.
 - Përgatitjen e pasqyrave financiare për MEF- in.
 - Përgatitjen e raportit financiar për Kuvendin e Komunës.
 - Bënë identifikimin , klasifikimin dhe vlerësimin e pronës në territorin e Komunës.
 - Ndhomon dhe këshillon komunitetin e biznesit në lëmin e tatimeve, taksave dhe obligimeve tjera ndaj Komunës

Buxheti per Drejtorin per Buxhet e Financa:

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	141,903	141,903	141,903
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	141,903	141,903	141,903
	Stafi	22	22	22

Drejtoria e Arsimit:

- DKA-ja ushtron funksion dhe përgjegjësi në bazë të Ligjit lidhur me organizimin e arsimit për fëmijë dh të rrituri duke filluar nga niveli: 0,1,2 dhe 3 dhe të rriturëve në Komunë;
 - Nxitë barazinë dhe mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunë, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit në të gjitha aspektet e tjera të arsimit;
 - Respekton dhe nxit të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre
 - Nxitë bashkëpunimin midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, familjes dhe komunitetit
 - Bën regjistrimin e të dhënave personale të nxënësve në një format të miratuar nga MASH-ti;
 - Bashkëpunon ngusht me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në interes dhe bashkëveprim në mes dy palëve në interes të nxënësve;
- Planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor fillor dhe të mesëm në Komunë, në konsultim me MASHT-in dhe komunat të tjera;
 - Në marrëveshje me MASHT-in, miraton rregullat për themelimin, shkrijen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike të niveleve 0,1,2 dhe 3 në Komunë;
 - Rregullon se cilat shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në komunë;
 - Bën mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike si, mirëqenien fizike të nxënësve duke përfshirë me ujë të freskët, ambient të shëndetshëm, ambient rrethues nëpër shkolla;
 - Nxit, në bashkëpunim me MASHT-in, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurimin në rrugë, fusha dhe shëndetin e nxënësve duke ju shmangur sëmurjeve ngjitëse si dhe aksionit kundër duhanit dhe drogës;
 - Miratimin e pushimeve lokale të shkollës;
 - Miratimin e rregullave të shkollës;
 - Punësimin dhe pagat për mësime të drejtorë të shkollave të komunës;
 - Shqyrton masat lidhur me ankesat e nxënësve;
 - Angazhohet për realizimin e arsimit special në konsultim me MASHT-in për nxënës me nevoja të veçanta;
 - Miraton rregullat për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave;

Buxheti per Arsim

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	9,176,288	9,176,288	9,176,288
2	Mallra dhe shërbime	1,077,067	1,137,273	1,162,273
3	Shpenzime komunale	130,000	130,000	130,000
4	Subvencione	100,000	120,000	130,000
5	Investime kapitale	1,660,000	1,700,000	1,810,000
	Gjithsej:	12,143,355	12,263,561	12,408,561
			1	
	Stafi	1477	1477	1477

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale bënë organizimin, menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes dhe kujdesit shëndetësor në mënyrë të vazhdueshme në tërë rrjetin shëndetësor të komunës.
- Ofrimi me kohë dhe cilësor i kujdesit parësor shëndetësor në të gjitha institucionet shëndetësore (QKMF,QMF dhe PMF).
- Zbatimi i programit të imunizimit në tërësi, sipas PZI.
- Përcjellja e situatës epidemiologjike në vazhdimësi.
- Sigurimi i të dhënave dhe zbatimi i përpikët i sistemit informativ shëndetësor (SISH).
- Furnizimi me barëra nga lista esenciale dhe me materiale tjera ndihmëse të evidentuara në regjistrin zyrtar.
- Sigurimi i kuadrit dhe resurseve humane në të gjitha shërbimet, sipas kritereve të OBSH.
- Aftësimi i kuadrove profesionale, qoftë me specializime apo trajnime të vazhdueshme.
- Përpilimi dhe implementimi i projekteve për investime kapitale dhe për situata tjera.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore.
- Edukimi dhe arsimimi shëndetësor i popullatës, me prioritet grupet e rrezikut.
- -Përcaktimi i prioriteteve në shëndetësi ndaj nënës dhe fëmijës,shëndeti mendor i bazuar në bashkësi,shëndeti oral dhe shëndeti stomatologjik etj.).
- Hulumtimi, identifikimi dhe vlerësimi sistematik i shëndetit dhe ambientit jetësor
- Sigurimi i ujit dhe ushqimit cilësor.
- Përkujdesja dhe furnizimi me aparaturë më të sofistikuar për diagnostikon
- Përkujdesja për shërbimin e transportit për qëllimet mjekësore,sipas standardeve bashk.
- Përmirësimi i pozitës materiale – stimulimi i punëtorëve shëndetësorë.
- Hulumtimi,identifikimi,përcjellja dhe përkujdesja për rastet sociale, të cilat kanë nevojë për asistencë.
- Përpilimi i projekteve dhe politikave për ndihmë familjeve të rrezikuara.
- Realizimi i të drejtave dhe obligimeve për kategoritë e caktuara (familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, invalidët civil,personat me aftësi të kufizuara,gratë kryefamiljare,fëmijët jetimë,personat e moshuar dhe ata të vetmuar.
- Identifikimi i rasteve që kanë të pazgjedhur strehim-banimin.
- Koordinimi i punëve me subjektët që kanë mundësi për zgjedhje të kësaj problematike.
- Koordinimi i punëve me Qendren për Strehim kolektiv-Lagjja Kuvajtjane.
- Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit të ndërsjell me autoritetin Shëndetësor të Qarkut Ministrinë e Shëndetësisë, institutin kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe me të gjitha institucionet qeveritare e joqeveritare,vendore e ndërkombëtare.

Buxheti per Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
-----	----------------------	------	------	------

1	Paga dhe mëditje	1,985,769	1,985,769	1,985,769
2	Mallra dhe shërbime	845,706	1,029,970	1,127,091
3	Shpenzime komunale	50,000	50,000	50,000
4	Subvencione	150,000	160,000	170,000
5	Investime kapitale	749,981	747,255	825,000
	Gjithsej:	3,781,456	3,972,994	4,157,860

	Stafi	274	274	274
--	--------------	-----	-----	-----

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);
- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera; Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Bën mbrojtjen e biodiversitetit, duke tentuar arritjen e bilancit ekologjik në territorin e komunës dhe më gjerë;
- Bën mbikëqyrjen për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të tokës prodhuese, si dhe mbrojtjen e akumulimeve gjenetike të natyrës;
- Harton programin dhe bën mbikëqyrjen e pamjeve të vlefshme të natyrës, propozon zonat e reja për mbrojtje, mbron dhe bën rehabilitimin e diversitetit dhe vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

Buxheti per Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	84,852	84,852	84,852
2	Mallra dhe shërbime	92,000	93,000	94,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	3,700,000	4,395,755	5,297,543
	Gjithsej:	3,876,852	4,573,607	5,476,395
	Stafi	12	12	12

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë

- Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi bënë matjen dhe kadastrin e tokave
- Përtërirjen e matjes dhe kadastrit të tokave.
- Punët e gjeodezisë për nevoja të posaçme.
- Kadastrin përques dhe objekteve nëntokësore.
- Përcaktimin e punëve lidhur me arondimin dhe kamasacionin e tokave.
- Evidentimin e pasurisë së patundshme dhe përcaktimin e të hyrave kadastrale
- Mbajtjen e arkivit teknik-origjinalitetin e planeve dhe hartave të punës themelore të gjeodezisë dhe shënimeve tjera. Jep shënime mbi pronarët ,shfrytëzuesit dhe të atyre që gëzojnë të drejtat e tokave, mbi sipërfaqet dhe të hyrat kadastrale, si dhe punë të tjera lidhur me mirëmbajtjen e matjeve dhe të kadastrit të tokave.
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe vendime të Kuvendit.
- Mbrojtjen, ruajtjen dhe evidentimin e patundshmërisë së Komunës.
- Qeverisjen ,shfrytëzimin dhe disponimin e patundshmërisë.
- Eksproprijimin, deeksproprijimin, arondimin dhe format tjera të pronësisë. Qarkullimin e tokës ndërtimore, shitblerjen e banesave dhe shtëpive.
- Drejtoria është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Pronës dhe Kadastrit

Buxheti i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	112,070	111,636	111,636
2	Mallra dhe shërbime	5,000	5,000	6,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	117,070	117,070	118,070
	Stafi	19	19	19

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Organizmi i jetës kulturore dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e kulturës rinisë dhe sportit. Krijimi dhe mbështetja e subjekteve dhe individëve krijues të fushave të ndryshme, aktiviteteve rinore dhe sportive në nivel të komunës. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm vlerash konkurruese. Gjetja e hapësirave të reja shprehëse dhe mbështetëse për zhvillimin e proklamuar të kulturës, aktiviteteve rinore dhe sportive.

Buxheti i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
1	Paga dhe mëditje	189,759	189,759	189,759
2	Mallra dhe shërbime	70,000	70,000	90,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	250,050	250,050	250,050
5	Investime kapitale	310,000	270,000	300,000
	Gjithsej:	819,809	779,809	829,809
	Stafi	29	29	29

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

- Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ofron mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave dhe skemave të nxehtësisë lokale.
- Sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
- Menaxhimi i investimeve kapitale në infrastrukturën publike, sidomos të kanalizimit fekal dhe atmosferik, urave, rregullimit të rrugëve me zhavorr, trotuareve, meremetimin e rrugëve të asfaltuara, etj.
- Komunitet do t'i rregullojnë shërbimet e ujit sipas marrëveshjeve mbi shërbimet të përcaktuara me rregullore.
- Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit.
- Bashkëpunon me kompanitë publike për caktimin e çmimeve për shërbime komunale .
- Angazhohet për gjetjen e donatoreve për realizimin e projekteve të natyrës së njëjtë.
- Cakton prioritetet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit.
- Ndërtimin e sistemeve të reja të kanalizimit si dhe rrjeteve të reja të ujësjellësit .
- Pastrimin, larjen dhe largimin e borës dhe akullit nga rrugët, sheshet dhe trotuarët.
- Përcjell funksionimin e tregjeve komunale .
- Kujdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve në komunë.
- Hartimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
- Vlerësimin e rrezikshmërisë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim, ndërmarrjen e masave parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare.
- Propozon formimin e njësisë për mbrojtje dhe shpëtim, kryen plotësimin e tyre me obligues dhe i kompletton ato me mjete adekuate për veprim, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
- Harton Planin e vlerësimit të rreziqeve në komunë
- Përgatitjen e programeve për aftësim të sferës së mbrojtjes dhe shpëtimit.
- Kujdeset për sigurimin dhe mirëmbajtjen e rezervave të mjeteve materiale, në rast fatkeqësie.
- Organizimin e funksionimit të sistemit të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit.
- Organizimin e mbrojtjes nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe avancimin e masave mbrojtëse kundër zjarrit.
- Komuna është përgjegjëse për transportin lokal brenda territorit të vet, në pajtim me Ligjin 2004/1 mbi transportin rrugor dhe do të ushtrijë pushtetin e vet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj.
- Koordinon aktivitetin mbi transportin publik të mallrave dhe udhëtarëve, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve.
- Cakton linjat për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban.
- Jep pëlqimin për regjistrimin e veprimtarisë së taksistëve, sipas rregullores së komunikacionit.
- Bën shpalljen e ankandëve publike për automjetet e konfiskuara, të cilat nuk tërhiqen në afatin e caktuar nga pronarët.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me Policinë e Kosovës, për rregullimin e transportit lokal.
- Cakton rrugët për të gjitha llojet dhe për automjetet (taksi, autobus, parkingje të limituara)
- Përkujset për shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve.
- Mbylljen e rrugëve në rast nevojë (gjatë festive shtetërore, manifestimeve, garave sportive, etj.).
- Përgjegës për ndriqimin publik, tabelat reklamuese, reklamat ndriquese të firmave dhe reklamat .
- Merr pjesë në mbikëqyrjen e punimeve dhe propozon anëtarë për komisionet e pranimit teknik të punëve të kryera-ndriqimi publik,
- Menaxhimin dhe kontrollimin e shesheve, që i përkasin komunës .

Buxheti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

NR.	Kategoritë ekonomike	2023	2024	2025
		194,372	194,372	194,372
1	Paga dhe mëditje			
2	Mallra dhe shërbime	660,000	685,000	695,000
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	100,000	100,000	100,000
5	Investime kapitale	2,330,000	3,125,000	2,840,000
	Gjithsej:	3,284,372	4,104,372	3,829,372
	Stafi	29	29	29

Drejtoria e Inspektionit

- Mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në territorin e komunës së Prishtinës;
- Mbikëqyrë dhe verifikon nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve komunale;
